



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Primijeno / Prodato Received / Delivery	21.10.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIPMSHCK	6386	/2022	1/1



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.798/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari - kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj- Demi anëtarë, si dhe Rushit Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kane shqyrtuar ankesën me numër A.nr.798/2022 të datës 14.09.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë:

Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, në çështjen juridike "*kërkesë nga marrëdhënia e punës*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 21.10.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET** si e bazuar ankesa me numër A.nr.798/2022 e datës 14.09.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. ANULOHET** Vendimi me numër protokolli 228/22-06/B i datës 08.09.2022 i Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm në Autoritetin Kosovar të Konkurrencës.
- III. MBETET në fuqi** Vendimi me numër protokolli 212/22-06/B i datës 08.08.2022 i nxjerrë nga Drejtori i Përgjithshëm në Autoritetin Kosovar të Konkurrencës.
- IV. OBLIGOHET** Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm në Autoritetin Kosovar të Konkurrencës, për zbatimin e këtij vendimi në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi dhe Udhëheqësja e Burimeve Njerëzore në Autoritetin Kosovar të Konkurrencës, që të ndërmer veprimet procedurale, që ankuesit ti kthehen ditët e pushimit vjetor të tërhequra për vitin 2022.
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.



A r s y e t i m

Ankuesi sipas shkresave të lëndës i punësuar në Autoritetin Kosovar të Konkurrencës në pozitën "Drejtor i Departamentit për Mbikëqyrjen e Tregut", me datë 21.07.2022 ka parashtruar kërkesë tek Drejtori i Përgjithshëm në Autoritetin Kosovar të Konkurrencës, për lejimin e pushimit pa pagesë për periudhën nga data 01.09.2022 deri me datë 28.02.2023, për përgatitje dhe regjistrim në doktoratë jashtë vendit, e cila kërkesë i është aprovuar dhe pushimi pa pagesë i është lejuar në periudhën 01.09.2022 deri me datë 28.02.2023 sipas Vendimit me numër protokoli 212/22-06/B

Me datë 08.09.2022 Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm në Autoritetin Kosovar të Konkurrencës, ka nxjerrë Vendimin me numër protokoli 228/22-06/B, me të cilin e ka shfuqizuar Vendimin e datës 08.08.2022 me numër protokoli 212/22-06/B, të Drejtorit të Përgjithshëm në Autoritetin Kosovar të Konkurrencës, duke e obliguar ankuesin që të paraqitet në punë me datë 09.09.2022, si dhe ditët e shfrytëzuara ti hiqen nga pushimi vjetor, nëse nuk ka ditë të pa shfrytëzuara, ti largohen mëditjet ditore për ditët sa ka munguar.

Kundër Vendimit me numër protokoli 228/22-06/B të datës 08.09.2022 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm në Autoritetin Kosovar të Konkurrencës, ankuesi me datë 13.09.2022 përmes e-mailit zyrtar: ankesa.kpmschck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë me numër protokoli 5379/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, e cila ankesë është regjistruar me date 14.09.2022 me pretendime ankimore se Vendimi i datës 08.09.2022 është tërësisht në kundërshtim me dispozitat ligjore që rregullojnë statusin e nëpunësit civil, në kundërshtim me parimet e përgjithshme të Ligjit Nr.06/114 për Zyrtarët Publikë si dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative. Ndërsa me datë 03.10.2022 i njëjti ka bërë plotësimin e ankesës me numër protokoli 5810/2022 të datës 14.09.2022, duke ofruar prova shtesë gjegjësisht dokumente shtese me qëllim të kompletimit të ankesës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, ankesën e ankuesit e ka proceduar me datë 19.09.2022 për përgjigje në ankesë tek Autoriteti Kosovar i Konkurrencës. Këshilli, me datë 22.09.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë e cila është protokolluar 5611/2022 dhe po ashtu me datë 22.09.2022 ka pranuar përgjigje/shkresë zyrtare nga Drejtori i Përgjithshëm në Autoritetin Kosovar të Konkurrencës, me numër protokoli 5612/2022, me shkresat e bashkëngjitura të lëndës..

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 14.09.2022 me numër protokoli 5379/2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes E-mailit zyrtar në adresën elektronike: ankesa.kpmschck@rks-gov.net të datës 13.09.2022; Akt emërimi i datës 27.05.2013 me numër protokoli 111/13; Vendimin me numër protokoli 228/22-06/B/1/2 i datës 08.09.2022 i Zëvendësuesit Drejtorit të Përgjithshëm në Autoritetin Kosovar të Konkurrencës; Vendimin me

numër protokollit 212/22-06/B/1/1 i datës 08.08.2022 i Drejtorit të Përgjithshëm në Autoritetin Kosovar të Konkurrencës; Plotësim i ankesës nga ankuesi me datë 03.10.2022 me numër protokollit 5810/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Shkresë zyrtare e datës 22.07.2022 e lëshuar nga Universiteti St. Kliment Ohridski Bitola, për ankuesin; E-mail i datës 21.09.2022 përgjigje nga Universiteti St. Kliment Ohridski Bitola për ankuesin, lidhur me kërkesën e datës 22.07.2022; E-mail i datës 30.09.2022 për mes adresës elektronike ankesa.kpmschck@rks-gov.net, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigje në ankesë e datës 22.09.2022 e pranuar nga Këshilli dhe e protokolluar me numër 5611/2022, me shkresat e bashkëngjitura, Kërkesë e datë 21.07.2022 nga ankuesi për pushim pa pagesë, e protokolluar me numër 199/22-08/B drejtuar mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë; Përgjigje e datë 22.09.2022 në ankesë sipas kërkesës së Këshillit, nga Drejtori i Përgjithshëm në Autoritetin Kosovar të Konkurrencës, e protokolluar me numër 5612/2022, me shkresat e bashkëngjitura, E-maili i datës 31.08.2022 njoftim nga ankuesi, për znj.N.B, z.S.B., z.A.T., znj.I.Z. dhe z.E.T.; E-mail i datës 01.09.2022 Njoftim nga z.S.B z.A.T.dhe znj.I.Z.; E-mail i datës Njoftim nga znj.I.Z. për z.S.B, z.B.M. dhe z.A.T.; E-Mail i datës 01.09.2022 Njoftim nga z.A.T.,për z.S.B.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit dhe pas analizimit të provave të lëndës ka konstatuar se ankesa e ankuesit
është e bazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit të parashtruar me datë 14.09.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili kundërshton Vendimin e datës 08.09.2022 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm në Autoritetin Kosovar të Konkurrencës, me numër protokollit 228/22-06/B/

Kolegji pasi ka analizuar shkresat e lëndës të bashkëngjitura nga palët në procedurë dhe pasi ka analizuar dispozitat ligjore që rregullojnë pushimin pa pagesë gjegjësisht Ligjin Nr.06/114për Zyrtarët Publikë përkatësisht nenin 18 paragrafin 4 dhe 5 si dhe Rregulloren nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë respektivisht nenin 14 i cili përcakton "*Pushimi pa pagesë 1. Zyrtari publike gëzon të drejtën për pushimi pa pagesë në pajtim me dispozitat e Ligjit të punës. 2. Në raste të veçanta zyrtari publik mund të përfitojë pushim pa pagesë, për nevoja të: 2.1. ngritjes apo arsimimit më të lartë profesional*", ka konstatuar se Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Autoritetet të Konkurrencës ka vepruar në përputhje me dispozitat e lartshënuar dhe nuk ka tejkaluar asnjë nga autorizimet e tij, Kolegji ka konstatuar në bazë të shkresave të lëndës se ankuesi posedon dëshmi të mjaftueshme për ngritje profesionale për të cilën gjë ka kërkuar pushimin pa pagesë.

Kolegji pasi ka analizuar dispozitat e lartshënuara si dhe dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, gjegjësisht nenin 57 i cili përcakton se "*Shfuqizimi i një akti administrativ të ligjshëm 1. Një akt administrativ i ligjshëm mund të shfuqizohet, për shkak të ndryshimit të situatës apo rrethanave faktike ose ligjore apo për shkak të arsyeve tjera të parapara me ligj, pa rënë kundërshtim me paragrafin 2 të këtij neni; 2. Përpos nëse parashihet ndryshe me ligj, një akt administrativ dobiprurës i ligjshëm, mund të shfuqizohet vetëm nëse shfuqizimi është i domosdoshëm për të parandaluar apo eliminuar një dëmtim serioz të jetës dhe shëndetit të njerëzve apo sigurisë publike, dhe kjo nuk do të mund të bëhet në mënyra tjera që do të cenonin më pak të drejtat apo interesat juridike të fituara të palës, prandaj nisur nga ajo që u tha më lartë si dhe në dispozitën e fundit të përshkruar në këtë vendim, Kolegji konstaton se*



Vendimi Nr.212/22-06/B i datës 08.08.2022 ka qenë tërësisht i ligjshëm dhe në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi që rregullojnë fushën e pushimit pa pagesë, prandaj Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë të Autoritetit të Konkurrencës ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi të lartshënuar si dhe ka tejkaluar autorizimet ligjore kur ka anuluar një akt administrativ të ligjshëm.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.798/2022

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm në Autoritetin Kosovar të Konkurrencës
- Udhëheqëses së Personelit në Autoritetin Kosovar të Konkurrencës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së